

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË
P nr. 43/2010
25 Maj 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, në trupit gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa, Kryetare, Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Gjyqtari i EULEX-it Nuno Madureira, anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Chiara Tagliani si procesmbajtëse në lëndën penale kundër;

A. L., i akuzuar për veprën penale **Vrasje e Rëndë** sipas Nenit 147 Pikat 3), 5) dhe 9) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe **Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve** sipas Nenit 328 Para. (2) të KPK;

sipas Padisë së Prokurorit Publik të Qarkut PP. 44/2010 të datës 08 Tetor 2010, të paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 13 Tetor 2010, dhe të konfirmuar me Aktvendimin për Konfirmimin e Aktakuzës të datës 24 Nëntor 2010;

pasi ka mbajtur Seancat publike të Shqyrtimit Gjyqësor më **17, 18, 21, 23 dhe 24 Maj 2012**, të gjitha në prani të të Akuzuarit **A. L.**, Avokatit të tij Mbrojtës Mahmut Halimi dhe Prokurorit Publik të EULEX-it nga Qarku I Mitrovicës Stefan Golfier, si dhe në prani të Palës së Dëmtuar Enver Nika më 17 dhe 23 Maj 2012;

pasi ka lëshuar 17 Maj 2012 një Aktvendim mbi Ndarjen e procedurave sa i përket akuzës Lëndim i Lehtë Trupor (Neni 153 Para. (1) i KPK);

pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 24 Maj 2012 dhe më 25 Maj 2012, sipas Nenit 392 para. (1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës (KPPK), më 25 Maj 2012, ka shpallur publikisht dhe në prani të të Akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës dhe Prokurorit Publik të EULEX-it këtë:

AKTGJYKIM

I Akuzuari **A. L.**, emri i babës H., emri i nënës S. dhe mbiemri i vajzërisë K., i lindur më 11.02.1976 në Fshatin K., Komuna e S., me banim në fshtin K., Komuna e S., Shqiptar i Kosovës, shkollen filllore të kryer, shkollën e lartë ekonomike të papërfunduar, i fejuar, pa fëmijë, automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, aktualisht në paraburgim që nga data 05.03.2010;

SHPALLET FAJTOR

- **sepse** më 19 Janar 2010 rreth orës 10-10:30 me qëllim ka privuar nga jeta A. N. duke shtënë në të shtatë herë me një pistoletë TT e kalibrit 7.62 X 25 mm në lagjen “K.” të fshatit M., Komuna e S.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari **A. L.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprimin kriminal

- **Vrasje** në shkelje të Nenit 146 të KPK – Pika 1 e aktakuzës-

I Akuzuari **A. L.** gjithashtu

SHPALLET FAJTOR

- **sepse** më 19 Janar 2010 për kryerjen e veprës së lartcekur penale ka përdorur një Pistoletë të cilën e kishte mbajtur në posedim për një periudhë të panjohur kohore dhe pa kurrëfarë autorizimi.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari **A. L.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprimin kriminal

- **Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve** në shkelje të Nenit 328 Para. (2) i KPK – Pika 2 e aktakuzës-

Prandaj, i Akuzuari **A. L.**

DËNOHET

- me **dhjetë** (10) vjet burgim për veprimin kriminal Vrasje
- me **tri** (3) vjet burgim për veprimin kriminal Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve.

Dënimi përmbledhës i caktohet **dymbëdhjetë (12) vjet burgim.**

Koha e kaluar në paraburgim nga data 05 Mars 2010 i llogaritet sipas Nenit 73 Para. (1) KPK.

I Akuzuari **A. L.** do ta paguajë shumën paushale prej pesëqindë (500) Euro për pjesën e shpenzimeve të procedurës penale dhe lirohet nga detyrimi që ti paguaj shpenzimet tjera sipas Nenit 102 Para. (4) i KPPK.

ARSYETIM

A. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 13 Tetor 2010 Prokuroria Publike e Qarkut të Mitrovicës ka ngritur Aktakuzën PPS nr. 44/2010 kundër të Akluzuarit në Gjykatën Përkatëse për akuzat Vrasje e Rëndë, sipas Nenit 147, Pikat 3), 5) dhe 9) e KPK, Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve sipas Nenit 328 Para. (2) i KPK, dhe Lëndim i Lehtë Trupor sipas Nenit 153 Para. (1) i KPK.
2. Aktakuza është konfirmuar me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 24 Nëntor 2010.
3. Më 10 Shkurt 2011 Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it në pajtim me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-035).
4. Me Aktvendimin e Kryetarit të Trupit Gjykues të lëshuar më 17 Maj 2012, është urdhëruar ndarja e Procedurave për akuzën Lëndim i Lehtë Trupor sa u përket të dy të Pandehurëve **A. L.** dhe **J. B.**
5. Seancat e Shqyrtimit Gjyqësor janë mbajtur më 17, 18, 21, 23 dhe 24 Maj 2012.
6. Aktgjykimi është shpallur më 25 Maj 2012.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

7. Sipas Nenit 23 Pika 1) i) e KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente për shqyrtimin e lëndëve për të cilat ligji parasheh shqiptimin e dënimit prej së pakut pesë vjetë burgim.
8. I Akuzuari në rastin në fjalë akuzohet për **Vrasje të Rëndë** sipas Nenit 147 Pikat 3), 5) dhe 9) të KPK dhe **-Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve** sipas Nenit 328 Para. (2) i KPK.
9. Lidhur me akuzën Vrasje e Rëndë, Neni 147, Pikat 3), 5) dhe 9), i KPK parasheh që: “Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:3) Privon

nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;5) Privon nga jeta personin tjetër duke vepruar mizorisht e dhunshëm;9) Privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta;”.

10. Lidhur me akuzën Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, Neni 328 Para. (2) i KPK parasheh që: “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 EUR ose me burgim prej një deri në tetë vjet.”.

11. Neni 27 Para. (1) i KPPK parasheh kompetencën territoriale të Gjykatës së Qarkut në qarkun ku pretendohet se është kryer krimi. Në bazë të Aktakuzës së ngritur, veprat e pretenduara penale kanë ndodhur në Lagjen K. të fshatit M. dhe në shtëpinë ku banon i Akuzuari, përkatësisht në fshatin K., që të dyja gjinden në Komunën e S., prandaj në kompetencë territoriale të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës.

12. Prandaj, duke marrë në konsiderim dënimin e paraparë për akuzat e lartcekura dhe qarkun ku pretendohet se janë kryer veprat penale, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është organi gjyqësor kompetent për gjykimin e kësaj lënde penale.

13. EULEX-i e ka marrë në kompetencë lëndën me Vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it të datës 10 Shkurt 2012 dhe në pajtim me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. (Ligji nr. 03/L-053).

14. Trupi Gjykues është i përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa, si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Gjyqtari i EULEX-it Nuno Madureira, anëtarë të trupit gjykues.

15. Asnjëra nga palët nuk e ka kundërshtuar kompetencën e gjykatës as përbërjen e Trupit Gjykues.

C. SHQYRTIMI GJYQËSOR

16. Seancat e Shqyrtimit Gjyqësor janë mbajtur më 17, 18, 21, 23 dhe 24 Maj 2012 dhe aktgjykimi është shpallur më 25 Maj 2012 në objektet e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Të gjitha seancat kanë qenë të hapura për publik dhe janë mbajtur në prani të të Akuzuarit **A. L.**, Avokatit Mbrojtës Mahmut Halimi (me përjashtim të seancës së mëngjesit të datës 18 Maj 2012 kur Z. Mahmut Halimi është zëvendësuar nga Avokati Mbrojtës Betim Shala) dhe të Prokurorit Publik të EULEX-it nga Qarku i Mitrovicës Stefan Golfier.

17. Gjatë seancës së Shqyrtimit Gjyqësor të datës 17 Maj 2012, për shkak se i Pandehuri **J. B.** nuk ka qenë prezent në vend dhe për shkak të pamundësisë së tij për të marrë pjesë

në procedurë, Kryetarja e Trupit Gjykes ka lëshuar një Aktvendim për ndarjen e procedurave ndaj të dy të Pandehurëve sa i përket akuzës Lëndim i Lehtë Trupor.

18. Në pajtim me Nenin 15 të KPPK, përkthyesit ndërkombëtar kanë ofruar përkthimin simultan gjatë tërë procedurës gjyqësore dhe të gjitha dokumentet relevante për gjykimin janë përkthyer në të dyja gjuhët Shqip dhe Anglisht.

D. DËSHMITË E PARAQITURA GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR

19. Gjatë Shqyrtimit Gjyqësor, u dëgjuan Dëshmitarët në vijim:

- E. N. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria dhe i cili ka qëndruar në seancë në cilësi të Palës së Dëmtuar) dhe H. N. (Dëshmitare e ftuar nga Prokuroria) janë dëgjuar më 17 Maj 2012;
- H. L. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria) dhe L. L. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria) janë dëgjuar më 18 Maj 2012;
- M. L. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria), O. L. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria), M. J. L. (Dëshmitare e ftuar nga Prokuroria) dhe Xh. K. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria) janë dëgjuar më 21 Maj 2012;
- A. K. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria), F. N. (Dëshmitar i ftuar nga Prokuroria) dhe F. D. (Dëshmitar i ftuar nga Mbrojtja e A. L.) janë dëgjuar më 23 Maj 2012. Për më tepër, gjatë seancës së 23 Majit 2012, Dëshmitari/ Pala e Dëmtuar E. N. është dëgjuar për herë të dytë.

20. Më 23 Maj 2012, dokumentet në vijim janë pranuar si dëshmi dhe janë lexuar në procesverbal .

21. Nga Mbëshjellësi i Lëndës # 1 të shkresave të lëndës të Prokurorisë:

- Raporti mjekësor, nga faqe 238 deri faqe 253, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;
- Raporti balistik i ekspertizës, nga faqe 256 deri faqe 265, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;
- Raporti i ekzaminimit të vendit të ngjarjes, duke përfshirë fotografitë, nga faqe 271 deri në faqe 284, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;
- Skica në faqe 291;
- Albumi i fotografive, nga faqe 292 deri në faqe 314;
- Raporti i ekzaminimit të veturës, nga faqe 315 deri në faqe 318, versioni në gjuhën angleze dhe shqipe;
- Një tjetër album me fotografi nga faqe 319 deri në faqe 328;
- Raporti i forenzikës, faqe 332 dhe faqe 333, versioni në gjuhën angleze dhe shqipe;

- Raporti i autopsisë, nga faqe 334 deri në faqe 336, versioni në gjuhën angleze dhe shqipe;
- Albumi me fotografi lidhur me autopsinë, faqe 337 deri në faqe 344;
- Dy skica tjera, faqe 345 dhe faqe 346;
- Një tjetër raport i autopsisë, nga faqe 349 deri në faqe 368, versioni në gjuhën angleze dhe shqipe;
- Më shumë fotografi nga faqe 369 deri në faqe 377;
- Fotografi bardh e zi, faqe 378 dhe faqe 379;
- Raporti i toksikologjisë, faqe 380 dhe faqe 381;
- Një tjetër opinion i ekspertëve, nga faqe 382 deri në faqe 392, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;
- Raporti identifikues forensik nga faqe 393 deri në faqe 396;
- Një tjetër album me fotografi nga faqe 397 deri në faqe 399;
- Raporti i hetuesisë 210 BE/021, nga faqe 429 deri në faqe 434 versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;
- Raporti rajonal i hetuesisë i datës 29 qershor 2010, faqe 441 dhe faqe 442, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe,;
- Informatat në raportin e hetuesisë të datës 22 Janar 2010, faqe 453 dhe faqe 454, versioni në gjuhën angleze dhe shqipe;
- Raporti i zyrtarit i datës 19 Janar 2010, faqe 457 versioni në gjuhë angleze dhe faqe 458 i versionit në gjuhë shqipe;
- Raporti i zyrtarit i datës 19 Janar 2010, faqe 459 dhe faqe 460, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;
- Raporti i zyrtarit i Stacionit të Policisë në Drenas, nga faqe 461 deri në faqe 464, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;
- Një raport tjetër i zyrtarit policor të Stacionit të Policisë në Drenas, faqe 457 dhe faqe 458, versioni në gjuhë angleze dhe shqipe;

22. Nga Mbështjellësi i Lëndës # 2 të shkresave të lëndës të Prokurorisë:

- Faqe 7 deri në faqe 154;&
- Faqe 155 deri në faqe 199;

23. Gjykata gjithashtu e konsideron si të pranueshme dëshminë nga faqe 49 deri në faqe 235 të Dosjes # 1 të dosjes së lëndës së Prokurorisë, duke patur parasysh se gjatë seancës të datës 23 Maj 2012 administrimi i këtyre dëshmive nuk është kontestuar nga asnjëra palë.

24. Gjatë Seancës Kryesore të datës 17 Maj 2012 pas leximit të Aktakuzës, i Akuzuari deklarohet “i pafajshëm” ndaj pikës së aktakuzës për Vrasje të Rëndë dhe “fajtor” për pikën e aktakuzës për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve.

25. Gjatë seancave të Shqyrtimit Gjyqësor të 23 dhe 24 Majit 2012, i Akuzuari ka dhënë deklaratën e tij dhe iu është përgjigjur pyetjeve.

26. Procedura e dëshmimeve ka përfunduar më 24 Maj 2012.

E. ANALIZA E DËSHMIVE

E1. Përmbledhje e dëshmimeve të paraqitura

27. Historiku i fakteve të pretenduara është si vijon: Viktima, i ndjeri A. N., ka qenë i martuar me E. N. 2., motrën e të Pandehurit, dhe ata të dy kanë jetuar në shtëpinë e familjes së Palës së Dëmtuar E. N. Më 16 Janar 2010 E. N. 2. është larguar nga shtëpia, si duket pa dhënë asnjë sqarim. Të dy familjet, ajo e të Pandehurit dhe ajo e viktimës, kanë bërë kërkime dhe hetime të ndryshme për kërkimin e saj. Gjatë një aksioni të tillë, i Pandehuri ka shtënë disaherë me armë në viktimën, duke shkaktuar vdekjen e tij.

28. Një listë e plotë e dëshmimeve të paraqitura dhe të cilësuar si të pranueshme në këtë lëndë penale është dhënë në pjesën e mësipërme të këtij Aktgjykimi. Këto dëshmi formojnë bazën për vendimin e Trupit Gjykses në këtë lëndë. Shumica e dëshmimeve të cekura kanë të bëjnë me akuzën për Vrasje të Rëndë dhe vetëm një pjesë më e vogël e dëshmimeve është e lidhur me pikën tjetër të Aktakuzës, përkatësisht akuza për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo shfrytëzim i Paautorizuar të Armëve.

29. Lidhur me akuzën Vrasje të Rëndë, Trupi Gjykses ka kërkuar dëshminë e një mori dëshmitarësh për të përcaktuar faktet e incidentit të datës 19 Janar 2010, që ka rezultuar me vdekjen e A. N. Trupi Gjykses i Gjykimit ka dëgjuar dëshminë e gjithësej njëmbëdhjetë (11) dëshmitarëve, dëshmia e të cilëve mund të klasifikohet në njërin nga këto tri kategori:

- i.) Personat e pranishëm gjatë kërimit bashkë me të Akuzuarin;
- ii.) Personat e afërt me të Akuzuarin apo viktimën që zbulojnë informatat e kaluarës lidhur me zhdukjen e E. N. 2. dhe ditën kritike;
- iii.) Dëshmitarët ekspertë, doktori i mjeksisë.

30. Dëshmitë e dëshmitarëve jipen shkurtimisht më poshtë.

i) Personat e pranishëm gjatë kërimit bashkë me të Akuzuarin

Dëshmia e Dëshmitarit dhe Palës së Dëmtuar E. N.¹

31. E. N. është babai i të ndjerit A. N. Në dëshminë e tij ai ka konfirmuar se zhdukja e E. N. 2. ka ndodhur më 16 Janar 2010. Ai gjithashtu ka paraqitur kujtimin e sekuencave të kërimit të saj, deri në ditën kritike kur është vrarë A. N.

32. Në bazë të shpjegimit të tij, M. L., L. L., i Akuzuari A. L. dhe ai vetë kanë inicuar kërkimin për E. N. 2. po atë mbrëmje kur është zhdukur, përkatësisht më 16 Janar 2010.

¹ Faqe 6 deri faqe 27 të Procesverbalit të Seacës Dëgjimore të datës 17 Maj 2012, Dosja e Gjykatës P. 43/10, Vëllimi I;

Të nesërmen, së bashku me të birin e tij të ndjerë, e kanë raportuar rastin në polici. Ata kanë vazhduar kërkimin në ditët në vijim, duke e kërkuar E. N. 2. në vende të ndryshme, si p.sh. në fshatërat M. dhe Q., mirëpo pa rezultat. Siç ishin marrur vesh, dëshmitari, së bashku me të ndjerin A. N., të Akuzuarin A. L. dhe H. L. është dashur të takohen më 19 Janar 2010 te shkolla në Q., me qëllim që t'i pyesin nxënësit për më shumë informata lidhur me ndonjë indicije të mundshme.

33. I Akuzuari A. L. nuk ka arritur fare te shkolla, por e ka kontaktuar H. L. dhe A. N. dhe i ka lutur që ta marrin me veturë nga Drenasi. Andaj, në ditën kritike, rreth orës 9-9:10, viktimë është nisur për ta marrë me veturë të Akuzuarin. Ata kanë udhëtuar bashkë nga Drenasi për në shtëpinë e dajës së të Akuzuarit në fshatin M. dhe vrasja ka ndodhur gjatë rrugës.

34. Dëshmitari ka marrë lajmin tragjik për vdekjen e djalit të tij nga kushërinjtë F. dhe Sh. Ata kanë marrë lajmin nga F. N. i cili e kishte dëgjuar këtë nga G. G. Ky i fundit, kishte mësuar për këtë nga vëllau i të Pandehurit, L. L., të cilit këtë ia kishte thënë vetë i Pandehuri përmes telefonit. Më 19 Janar 2010 G. G. i kishte thënë Dëshmitarit se E. N. 2. kishte vdekur dhe se trupi i saj ishte gjetur i varur në pyll dhe ishte ngrënë nga qentë.

35. Në bazë të deklaratës së Dëshmitarit, gjatë kërkimit, **A. L.** dukej se ishte nervoz për zhdukjen e motrës së tij dhe i "tërhequr". Megjithatë, ai nuk kishte bërë asnjë akuzë në drejtim të A., dhe Dëshmitari fare nuk dyshonte që i pandehuri ta kishte bërë vrasjen. Marrëdhëniet ndërmjet familjes së të Pandehurit dhe të viktimës, kanë qenë gjithmonë miqësore para se të ndodhte ky rast. Megjithatë, Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se në mbrëmjen e 17 Janarit 2010 djali i tij i ndjerë ishte kërcënuar përmes telefonit nga M. L., njëri nga vëllezërit e E. N. 2. që jeton në Gjermani.

36. Më 22 Qeshor 2010 E. N. 2. është konstatuar se ishte gjallë në një kafene në Prizren. Por, Dëshmitari ka deklaruar se familja e saj nuk kishte tentuar që t'i shprehte ngushëllime atij për humbjen e djalit, as drejtëpërdrejtë dhe as përmes ndërmjetësve.

Dëshmia e Dëshmitarit H. L.²

37. Dëshmitari është kusheri i të Pandehurit nga ana e babait. Dëshmitari ka deklaruar se ka marr pjesë në kërkimin e E. N. 2. më 18 Janar 2010 së bashku me të Akuzuarin, E. N. dhe A. N. Dëshmitari ka pohuar se në një moment të caktuar gjatë kërkimit E. N. ka përmendur thashethëmat se disa gjurmë të këmbëve, me gjasë të E. N. 2., janë parë në drejtim të malit.

38. Në bazë të deklaratës së Dëshmitarit, i Akuzuari dukej i shqetësuar, por kurr nuk kishte paraqitur kërcënime në drejtim të familjes N. dhe Dëshmitari kurr nuk e kishte parë të ketë bartur armë. Ai gjithashtu ka thënë se marrëdhëniet ndërmjet të dy familjeve gjithnjë kanë qenë të mira.

² Faqe 2 deri në faqe 11 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 18 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

39. Pastaj, në mëngjesin e ditës kritike, derisa ishte në shkollë në fshatin Q., ai ka konfirmuar se ka pranuar një telefonatë nga i Pandehuri duke kërkuar që E. N. dhe A. N. ta marrin atë me veturë në Drenas. Ai ka deklaruar se rreth orës 9:30 , ka tentuar ta thërras të Akuzuarin nga numri i tij personal, përkatësisht 049 __ __, megjithatë fare nuk ka arritur ta marrë në linjë. Më vonë ka marr një thirrje nga **A. L.** duke thënë “Nuk keni nevojë të prisni. U krye tëra. Vajza është e vdekur dhe nuk ka arsye që ta kërkosh sepse e kanë gjetur trupin e saj dhe trupi i saj është në Mitrovicë. Ashtu si ma kanë thyer zemrën, ua kam thyer edhe unë atyre dhe ua kam vrrarë djalin dhe tani E. N. 2. dhe A. N. janë bashk në botën tjetër, E. N. 2. është gjetur e vdekur” .

ii) Personat e afërt me të Akuzuarin apo viktimën të cilët kanë zbuluar informata nga e kaluara lidhur me zhdukjen e E. N. 2. dhe në ditën kritike

Dëshmia e Dëshmitares H. N.³

40. Dëshmitarja është nëna e të ndjerit A. N. dhe bashkëshortja e Palës së Dëmtuar. Në dëshminë e saj Dëshmitarja ka konfirmuar se E. N. 2. ka dalë nga shtëpia e tyre dhe është zhdukur më 16 Janar 2010 dhe se M. L., L. L. dhe A. L. kanë shkuar në shtëpinë e N. natën e njëjtë. Ajo mohon të ketë patur ndonjë problem me E. N. 2. para zhdukjes së saj dhe deklaroi se asnjë fajësim apo akuzë nuk është adresuar në drejtim të saj për zhdukjen e E. N. 2.. Megjithatë, ajo konfirmoi atë që u tha nga Pala e Dëmtuar, E. N., lidhur me thirrjen kërcënuese telefonike që ka marrë i ndjeri A. N. nga M. L. 2., njëri nga vëllezërit e E. N. 2. që jeton në Gjermani.

41. Ajo deklaroi se lajmin e vdekjes së dalit të saj ka dëgjuar më 19 Janar 2010 rreth orës 12:00 nga S. N., njëri nga kushërinjtë e E. N.. Ajo konfirmoi se bashkëshorti i saj i ka treguar se lajmi është shpërndarë nga F. N., i cili këtë e kishtë dëgjuar nga G. G..

Dëshmia e Dëshmitarit F. N.⁴

42. Dëshmitari nuk është i afërt me të Pandehurin. Ai ka deklaruar se lajmin e vdekjes së A. N. e kishte marrë nga G. G. i cili këtë e kishtë dëgjuar nga L. L., njëri nga vëllezërit e të Akuzuarit. Ai konfirmoi se telefonatën me lajmin e ka marrë në ora 11:45. Ai më pas i ka njoftuar Sh. dhe F. N. 2. dhe u ka thënë që t’ia përcjellin lajmin E. N.

³ Faqe 28 deri në faqe 34 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 17 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

⁴ Faqe 4 deri në faqe 10 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 23 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

*Dëshmia e Dëshmitarit L. L.*⁵

43. Dëshmitari është vëllau i të Pandehurit. Ai ka konfirmuar se e kishe marrë një telefonatë nga E. N. në mbrëmjen e 16 Janarit 2010 duke e njoftuar atë mbi zhdukjen e E. N. 2.. Ai nuk ka marrë pjesë në kërkime së bashku me të Akuzuarin, E. N. dhe A. N., por është informuar vazhdimisht për rezultatete e kerkimit përmes telefonit.

44. Ai ka deklaruar se marrëdhëniet ndërmjet dy familjeve kanë qenë gjithmonë të mira. Megjithatë, ai më pas ka thënë se gjatë ditëve nga zhdukja e E. N. 2. deri në momentin e vrasjes së A. N., në familje kanë diskutuar për marrëdhëniet e rënda ndërmjet E. N. 2. dhe H. N. Dëshmitari ka shtuar se nuk kishte njohuri se vëllai i tij A. L. posedonte armë.

45. Ai ka deklaruar se në ditën kritike, më 19 Janar 2010, është thirrur nga një numër i panjohur rreth orës 10:15, nga një person me zë femre dhe që kinse quhej Shpresa, duke e njoftuar atë se E. N. 2. kishte vdekur, se trupi i saj gjindej në Mitrovicë dhe se do të dërgohej te shtëpia e tyre më vonë gjatë ditës. Thirrja është marrë në praninë e G. G.

*Dëshmia e Dëshmitarit M. L.*⁶

46. Dëshmitari është vëllai i të Pandehurit. Ai ka deklaruar se në mbrëmjen e 16 Janarit 2010 E. N. e ka thirrur atë për ta njoftuar për zhdukjen e E. N. 2.. Më pas, ai, së bashku me L. L., kanë shkuar te shtëpia e N.ve në fshatin G., ndërsa i Akuzuari iu ka bashkangjitur më vonë, pasi që ishte i përfshirë në një aksident trafiku. Më 19 Janar 2010, një patrullë e policisë ka ardhur në shtëpinë e familes L. për të kërkuar A. L. Vetëm atëherë, sipas Dëshmitarit, familja kishte mësuar për zhdukjen e E. N. 2..

47. Dëshmitari ka cekur se gjatë periudhës kritike i Akuzuari gjithnjë dukej i qetë dhe se nuk janë përhapur fjalë rreth zhdukjes së E. N. 2. përveq një mospajtimi ndërmjet asaj dhe H. N. lidhur me pastrimin e një ballkoni, të cilën Dëshmitarit ia kishte thënë E. N. në mbrëmjen e 16 Janarit 2010.

*Dëshmia e Dëshmitarit O. L.*⁷

48. Dëshmitari është vëllau i të Pandehurit. Ai jeton në Gjermani dhe nuk ishte i pranishëm në Kosovë në periudhën kritike. Më 20 Janar 2010 ai është kthyer nga Gjermania në Kosovë, pasi ishte njoftuar për zhdukjen e motrës së tij dhe të vrasjes së kryer nga vëllau i tij. Ai gjithashtu ka deklaruar se, në bazë të asaj që kishte dëgjuar pas kthimit të tij nga Gjermania, ai ka dyshuar në H. N. lidhur me zhdukjen e motrës së tij. Dëshmitari mendon se vrasja nuk është kryer sipas Kanunit, një përmbledhje e ligjeve zakonore shqiptare, por në bazë të “shkaqeve të gabuara”, pra aksidentalisht.

⁵ Faqe 12 deri në faqe 18 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 18 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

⁶ Faqe 2 deri në faqe 7 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 21 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

⁷ Faqe 8 deri në faqe 16 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 21 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

*Dëshmia e Dëshmitarës M. J. L.*⁸

49. Dëshmitarja është motra e të Pandehurit. Ajo ka pohuar se motra e saj E. N. 2. ishte duke e kaluar një kohë të vështirë në shtëpinë e Nikajve. Ajo gjithashtu ka cekur se E. N. 2. si duket është detyruar nga H. N. ta ndërpres një shtatzëni. Ajo e kishte njoftuar nënën e saj dhe vëllaun e saj A. në pika të përgjithshme për problemet e E. N. 2.. Ajo e kishte njoftuar vëllaun e saj O. vetëm për disa nga problemet lidhur me shtatëzëninë e E. N. 2. dhe kjo ka ndodhur para se O. të kthehej në Kosovë nga Gjermania, përkatësisht pas zhdukjes së E. N. 2. por para vrasjes së A. N.

50. Ajo ka deklaruar se marrëdhëniet ndërmjet të dy familjeve gjithmonë kanë qenë të mira. Kështu, Dëshmitarja ka mohuar një pjesë të deklaratës së dhënë para policisë më 23 Prill 2010⁹, përkatësisht atë që ka cekur se i Akuzuari e ka kërcënuar A. përmes telefonit duke i thënë ‘nëse ajo është gjallë do të gjindet, dhe nëse nuk është gjallë, ti do të kesh telashe’.

*Dëshmitë e Dëshmitarëve Xh. K.*¹⁰ dhe A. K.¹¹

51. Të dy Dëshmitarët kujtuan momentin kur e kanë gjetur veturën brenda së cilës ishte trupi i pajetë i A. N.

52. Dëshmitari Xh. K. ka deklaruar se, mëngjesin e 19 Janarit 2010, rreth orës 11:00 ai kishte parë një veturë të ndalur dhe kur ishte afruar kishte dalluar trupin e pajetë të A. N. Ai pastaj e kishte thirrur Policinë dhe kishte pritur derisa të vijnë ata.

53. Dëshmitari A. K. kishte shkuar në vendin e ngjarjes pasi që ishte thirrur nga disa fëmijë. Sidoqoftë, Dëshmitarit nuk iu ka kujtuar saktësisht se në sa ora kishte ndodhur kjo, madje as pasi i është kujtuar deklarata që e kishte dhënë në polici më 19 Janar 2010¹².

⁸ Faqe 17 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 21 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

⁹ Faqe 127 deri në faqe 136 të Mbështjellësit të Lëndës # 1 të shkresave të lëndës së Prokurorisë;

¹⁰ Faqe 25 deri në faqe 26 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 21 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

¹¹ Faqe 2 deri në faqe 4 të Procesverbalit të Seancës Dëgjimore të datës 23 Maj 2012, Mbështjellësi i Lëndës P. 43/10, Vëllimi I;

¹² Faqe 214 deri 219 të mbështjellësi të lëndës # 1 të shkresave të lëndës së Prokurorisë;

iii) Dëshmitarët Ekspertë: Doktorit i Mjeksisë

*Dëshmia e Ekspertit, Doktorit F. D.*¹³

54. Eksperti është neuropsikiatër dhe ka qenë udhëheqës i ekipit të ekspertëve që kanë ekzaminuar të Akuzuarin. Doktorit ka konfirmuar se ekipi nuk e përjashton mundësinë se vrasja ka mundur të kryhet në një gjendje të afektit. Megjithatë, doktorit gjithashtu ka deklaruar se fakti se i Akuzuari do të ishte prekur nga amnesia pasi ta kishte kryer krimin nuk është indikator i sigurtë mbi gjendjen e afektit mendor.

55. Eksperti gjithashtu ka cekur se nuk janë gjetur asnjë varësi apo ç'rregullim psikik pas ekzaminimit të të Pandehurit. Kishte indikacione se i Akuzuari kishte një personalitet egocentrik, posesiv dhe të ndjeshëm që e bënte atë të zhvillonte reagime të shpejta nga shqetësimi.

56. Eksperti i ka mbështetur konkluzionet e raportit mjekësor në tërësi.¹⁴

*E2. Deklarata e të Akuzuarit A. L.*¹⁵

57. I Akuzuari asnjëherë nuk e ka mohuar kryerjen e vrasjes. Mirëpo, përgjatë tërë Gjykimit ai pretendoi se kishte vepruar në një gjendje të tronditjes së përgjithshme mendore.

58. Ai ka deklaruar se kishte dëgjuar për zhdukjen e E. N. 2. në mbrëmjen e 16 Janarit 2010. Po atë mbrëmje ai kishte shkuar te shtëpia e familjës N. Ai kishte arritur atje me vonesë, pasi që ishte përfshirë në një aksident me veturë. Aty ai ka ndenjur ulur së bashku me Palën e Dëmtuar E. N. dhe Dëshmitarët M. L. dhe L. L. Ata kanë diskutuar rrethanat e zhdukjes së motrës së tij. Ai kishte dëgjuar për disa mosmarrëveshje ndërmjet E. N. 2. dhe vjehrrës së saj lidhur me një ballkon. Pastaj, të gjithë personat e lartcekur u pajtuan që të vazhdojnë me organizimin e kërkimeve për E. N. 2. në ditët në vijim.

59. I Akuzuari ka marrë pjesë në këto kërkime më 17 Janar 2010 dhe më 18 janar 2010 bashk me E. N. dhe A. N.. Të hënën më 18 Janar 2010 i Akuzuari kishte dëgjuar nga E. N. se ishin gjetur gjurmët e këmbëve në drejtim të pyejeve dhe malit. Në mbrëmjen e 18 janarit 2010 ai, H. L., E. N. dhe A. N. janë pajtuar që të takohen te shkolla e fshatit Q. të nesërmen në mëngjes për të vazhduar kërkimin për motrën e tij. Meqenëse i Akuzuari, si pasojë e incidentit të datës 16 Janar 2010, nuk ka pasur mjet transporti që të shkojë atje, në mëngjesin e datës 19 janar 2010, ai ka thirrur H. L. dhe të ndjerin A. N., nga të cilët

¹³ Faqe 13 deri 19 të procesverbalit të seancës së datës 23 Maj 2012, Mbështjellësi I Gjykatës P. 43/10, Vëllimi I;

¹⁴ Faqe 238 deri 253 të mbështjellësi të lëndës # 1 të shkresave të lëndës së Prokurorisë;;

¹⁵ Faqe 21 deri 32 të procesverbalit të seancës së datës 23 Maj 201 2& faqe 1 deri 5 të procesverbalit të seancës së datës 24 Maj 2012, të dyja dokumentet në mbështjellësin e gjykatës P. 43/10, Vëllimi I;

kishte kërkuar që ta merrnin në Drenas te shkolla e rrobaqepësisë, përball fabrikës Finerka. A. N. kishte shkuar ta merrte atë rreth orës 9:00-9:20. Megjithatë, në vendë se të ktheheshin te shkolla në Q., ata kishin shkuar për në fshatin M., për të vazhduar përpjekjet për ta gjetur E. N. 2. te daja i saj.

60. Gjatë atij udhëtimi ka ndodhur incidenti. Sipas dëshmisë së tij, i Pandehuri kishte pranuar një thirrje telefoni gjersa po ngiste veturën, rreth orës 10:30. Gjatë asaj thirrje telefonike, një zë femre i kishte thënë se nuk kishte nevojë që ta kërkonte më motrën e tij, pasi që ajo ishte gjetur e varur në mal dhe trupi i saj ishte ngrënë nga qentë.

61. Të Akuzuarit nuk i kujtohet se cilën kartelë telefoni e kishte përdorur, dhe aas nuk ishte në gjendje që të japë ndonjë indikacion lidhur me numrin i cili e kishte thirrur. Ai ka theksuar se ekrani i telefonit të tij ishte thyer si pasojë e aksidentit me veturë të cilën e kishte pasur më 16 janar 2010, edhe një arsye më shumë për pamundësinë që ai ta njihte numrin që e kishte thirrur.

62. Për shkak të valëve të dobëta në atë zonë, i Akuzuari kishte dalur nga vetura për ta pranuar thirrjen , gjersa viktima, që ishte shoferi, kishte ndenjur brenda në veturë.

63. I akuzuari ka deklaruar se, për shkak të informatave që i kishte marrë përmes telefonit ai kishte humbur kontrollin dhe i kishte rënë terr para sysh dhe se vrasja kishte ndodhur si pasojë e kësaj humbje të kontrollit. Ai nuk ka mundur të japë ndonjë informatë konkrete se si e kishte vrarë viktimën dhe se ai ka shtuar se atij i kishte rënë të fiktë pas të shtënave. Atij i kujtohet që kishte folur me H. L. pak kohë pas incidentit kritik, por atij nuk i kujtohet përmbajtja e saktë e thirrjes.

64. Posa kishte rimarrë kontrollin, ai ishte nisur në drejtim të Mitrovicës dhe më pastaj në drejtim të Hungarisë, duke u ndjerë tepër i turpëruar që kishte vrarë një anëtar të familjes dhe, prandaj, nuk kishte dashur të kthehej në shtëpi.

65. I Akuzuari ka pranuar se gjatë tërë kohës së kërkimit të E. N. 2. me vete ka bartur armë , përkatësisht revolen TT. Ai ka deklaruar se arsyet për këtë kanë qenë kërkimet për E. N. 2. në të gjitha orët e mundshme, edhe gjatë natës, dhe se udhëtimi natën nëpër fshatra mund të jetë i rrezikshëm për shkak të prezencës së “ personave të maskuar”, përkatësisht plaçkitësve.

66. Ai ia kishte dalur të udhëtojë drejt Hungarisë pasi me vete kishte 2000 Euro, pasi që ato ditë kishte për qëllim të blejë dhurata për nusen e ardhshme të tij, për ditëlindje, që ishte më 15 Janar, dhe për dasmën të cilën e kishin caktuar që ta bëjnë brenda dy javësh.

67. I Akuzuari kishte marrëdhënie të mira me familjen e N., sidomos me A. me të cilin ishte shumë i afërt.

E3. Vlerësimi i dëshmive të prezentuara

68. Gjykata duhej të vërtetonte se cilat ishin faktet e vërtetuara në bazë të dëshmive të procesuara të cilat ishin paraqitur kundër të Akuzuarit **A. L.** për veprën penale Vrasje e Rëndë, Neni 147 Pikat 3), 5) dhe 9) KPK, dhe për veprën penale Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, Neni 328 Paragrafi(2) i KPK, dhe gjithashtu në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të Akuzuarit.

69. Sipas dëshmive të paraqitura dhe të procesuara gjatë Shqyrtimit Gjyqësor, Gjykata ka marrë në konsiderim këto fakte relevante si të vërtetuara përtej dyshimit të bazuar.

Dëshmitë lidhur me akuzën Vrasje e Rëndë

70. ***Është e pakontestueshme se në ditën kritike viktima A. N. ka pësuar lëndime të shumta të cilat kanë rezultuar me vdekjen e tij.*** Autopsia e plotë e bërë në trupin e të vdekurit ka zbuluar nëntë lëndime të identifikuar nga Mjeku Ligjor nga DML si plagë nga të shtënat me armë, pesë prej tyre në pjesën e trupit që duket nga përpara dhe katër të tjerat në pjesën e trupit që duket nga prapa. Shkaku i vdekjes, siç përcaktohet nga Mjeku i mjekësisë ligjore, ishte “gjakderdhja nga lëndimet e shumta nga të shtënat me armë”.¹⁶

71. Trupi Gjykues është plotësisht në dijeni se nuk është gjetur kurrfarë arme dhe se nuk ka dëshmitarë të drejtpërdrejtë të incidentit.

72. Megjithatë, edhe pse i Akuzuari nuk ka mundur ta përshkruajë modalitetin e saktë në të cilin e ka kryer vrasjen, ai e ka pranuar se vërtet e ka vrarë të ndjerin A. N. Kurrë nuk ka qenë kontestuese dhe, prandaj, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se në mëngjesin e datës 19 janar 2010 rreth orës 10-10:30, në lagjen “K.” të fshatit M., Komuna e S., i Akuzuari **A. L.** e ka privuar nga jeta të ndjerin A. N. gjerësa ishin bashkë në veturën e viktimës të tipt Golf 2, ngjyrë e kaltërt e mbylltë me nr. targash _____. Ngjajshëm me këtë, është vërtetuar gjithashtu përtej dyshimit të bazuar se viktima ka qenë në ulësen e shoferit dhe se në të është shtënë nga drejtimi i pasagjerit – ana e djathtë e veturës, siç pohon i pandehuri dhe vërtetohet nga dëshmia e foto albumit. Fotografitë e procesuara gjithashtu konfirmojnë atë që kishte deklaruar i Akuzuari, përkatësisht se në momentin kritik vetura është ndalur, është futur në shpejtësinë e parë dhe me frenin e dorës të ngrehur.¹⁷ Në të vërtetë, i Akuzuari në deklaratën e tij i ka pranuar në mënyrë eksplicite të gjitha këto që u cekën më lartë. Gjithashtu, nuk ka indikacione se ishte e përfshirë ndonjë palë e tretë dhe kishte i kishte shkaktuar lëndimet viktimës.

¹⁶Raporti i Autopsisë I datës 20 Janar 2010, Faqe 349 e mbështjellësit # 1 të shkresave të lëndës së Prokurorisë

¹⁷Foto numër 12 faqe 299 e Mbështjellësit # 1 të shkresave të lëndës së Prokurorisë;

73. Prandaj, në bazë të asaj që u cek më lart, Trupi Gjykses erdhi në përfundim se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se A. N. ka vdekur si rezultat i të shtënave me armë nga i Akuzuari.

74. Pastaj trupi Gjykses u kthye për të vlerësuar nëse në rastin në fjalë plotësohet ndonjë nga faktorët rëndues siç kualifikohen në Pikat 3), 5) dhe 9) të Nenit 147 të KPK.

75. Për tu kualifikuar si Vrasje e Rëndë nga Neni 147 Pika 3) e KPK, fakti i privimit të dikujt nga jeta duhet të ekzekutohet “ në mënyrë të mizore dhe dinake”.

76. Në këtë rast, Trupi Gjykses konsideron se elementet e mizorisë dhe dinakërisë nuk mund të vërtetohen përtej dyshimit të bazuar.

77. Mëngjesin e 19 janarit 2010 i Akuzuari ishte në Drenas pa mjet transporti për të arritur të shkolla në Q. ku, ashtu si janë marrë vesh, ai duhej të takohej me H. L., E. N. dhe A. N.. Gjykata e vlerësoi këtë fakt si të besueshëm, kryesisht për faktin se vetura e të Pandehurit nuk ishte funksionale si rezultat i aksidentit të datës 16 Janar 2010.

78. Fakti më relevant ishte ai që i Akuzuari kishte kërkuar fillimisht duke thirrur H. L.. Përmes tij, i Akuzuari kishte kërkuar nga E. N. dhe A. N. që ta marrin me veturë. Këto rrethana konfirmohen nga dëshmitë e H. L. dhe E. N.. Ky i fundit nuk iu kishte bashkangjitur të birit të tij në udhëtim me veturë vetëm për shkak se, sipas zgjedhjes së tij, kishte vendosur që të qëndronte në Q. dhe të vazhdonte kërkimin.

79. Andaj, përjashtohet mundësia se i Akuzuari do të mund të kishte sajuar një skenarë mashtrues, duke kërkuar që ta marrin me veturë, që ta tërheq viktimit me qëllim që ta vras atë.

80. Sa i përket elementit të mizorisë, është vlerësuar si në vijim. Mizoria do të implikonte shkaktimin e dhimbjes apo vuajtjes, gjë që nuk ka mundur të vërtetohet në rastin konkret. **Mizoria** sipas përkufizimit përfshinë trajtimin abuziv, mizor dhe johuman që do të rezultonte në shkaktimin brutal dhe të panevojshëm të vuajtjes ndaj trupit apo mendjes. Pavarësisht faktit se viktima është qëlluar disa herë, nuk ka gjurmë të ndonjë lloji specifik të trajtimit mizor dhe, rrjedhimisht, as shenja të vuajtjes së pamëshirshme të shkaktuar ndaj viktimit. Në fakt, ashtu si është vlerësuar në Raportin e lartcekur të Forenzikës, të gjitha lëndimet e gjetura në trupin e viktimit i atribuohen ekskluzivisht të shtënave me armë zjarri.

81. Trupi Gjykses më pas vlerësoi pikën 5) të Nenit 147. Që të cilësohet si Vrasje e Rëndë sipas Nenit 147 pika 5) të KPK-së, fakti i privimit të dikujt nga jeta duhet të ekzekutohet “duke vepruar mizorisht e dhunshëm”. Çdo vrasje në vete është kulminacioni i një veprimi të dhunshëm. Ashtu si është cekur më lartë, për komponentin e mizorisë, edhe specifikiteti i dhunës dhe pamëshirshmërisë nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm në bazë të provave të administruara. Në fakt, në bazë të raportit të forenzikës dhe autopsisë, viktima ka vdekur nga hemorragjia e shkaktuar nga

disa të shtëna me armë zjarri dhe nuk ka gjurmë që do të indikojnë se ai ishte ekspozuar ndonjë formë tjetër të dhunës.

82. Trupi Gjykses pastaj ka vlerësuar pikën 9) të Nenit 147. Për tu cilësuar si Vrasje e Rëndë sipas Nenit 147, pika 9) të KPK-së, fakti i privimit të dikujt nga jeta duhet të ekzekutohet nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta”. Lidhur me këtë element, Trupi Gjykses vlerëson se një lloj i planifikimit do të mund të kishte ndodhur.

83. Ngjarjet që kanë filluar nga zhdukja e E. N. 2.. Gjasat më të mëdha janë se kjo ishte e lidhur me ndonjë pakënaqësi me jetën e saj të përditshme në familjen N.. Edhe nëse arsyeja e saktë e largimit të saj nuk mund të përcaktohet me siguri, në bazë të dëshmive të Dëshmitarëve L. L., M. L., O. L. dhe M. J. L., si dhe në bazë të dëshmisë së të Akuzuarit, kjo mund të lidhet me marrëdhëniet e çrregulluara ndërmjet E. N. 2. dhe vjehrrës së saj H. N.. Megjithatë, nuk mund të përcaktohet me siguri se familja L. e ka lidhur zhdukjen e E. N. 2. me ndonjë veprim apo sjellje specifike të H. N.. Lidhur me këtë, Dëshmitarja M. J. L. ka ofruar shpjegime të konfliktit. Ajo fillimisht ka deklaruar se ajo kurrë nuk ia ka përmendur asnjë anëtar të familjes faktin se E. N. 2. ishte e detyruar të abortonte. Vetëm më vonë ajo ka pohuar se këtë informatë ia kishte zbuluar pjesërisht të vëllait O. L..

84. Nuk ka elemente solide që të vërtetohet me siguri se familja e E. N. 2. kishte planifikuar të hakmerrej. Vërtetë ka indikacione se familja L. do të mund të kishte dyshuar, madje edhe gjatë kërkimeve, se E. N. 2. mund të kishte vdekur, pasi që qarkullonin fjalët lidhur me gjurmët e këmbëve që çonin në pyll. Megjithatë, dëshmitë e Dëshmitarëve H. N., E. N. dhe H. L. janë të qëndrueshme se asnjë akuzë apo kërcënim konkret nuk ishte adresuar ndaj familjes N.. Gjatë kërkimit, i Pandehuri përgjithësisht dukej i përmbajtur dhe nuk ka ngritur ndonjë dyshim, madje as te babai i viktimës, E. N..

85. Në të vërtetë është zbuluar nga Dëshmitarët E. N. dhe H. N. se M. L. 2. ka adresuar disa kërcënime drejtë A. N. përmes një telefonate. Megjithatë, në bazë të vetëm këtij aspekti nuk mund të vlerësohet përtej dyshimit të arsyeshëm se familja e L. ka planifikuar vrasjen e A. N. për hamarrje. Nuk është e pazakontë se në kohë të krizës si ato të shkaktuara nga zhdukja e një anëtar të familjes, tensionet akumulohen, konfliktet mund të eskalojnë dhe marrëdhëniet mund të çrregullohen. Megjithatë, kjo domosdoshmërisht nuk përcillet me realizimin e një plani për hakmarrje.

86. Për më tepër, lidhur me atë se çka ka mundur të nxis reagimin e të Pandehurit që ta vras A. N., Gjykata konsideron si vijon. Duke e patur parasysh se asnjë dëshmitarë okularë nuk ishte i pranishëm në momentin kritik, Gjykata vetëm mund të mbështetet në vlerësimin e regjistrimeve të transkriptave telefonike¹⁸. Andaj, mund të vërtetohet se dy thirrje telefonike janë bërë nga Dëshmitari H. L. drejtë telefonit të të Akuzuarit, një para incidentit kritik në ora 9:58 dhe një pas incidentit, në ora 10:39, ashtu si është deklaruar edhe nga vetë Dëshmitari.

87. Për shkak të kohëzgjatjes së shkurtë të thirrjes së parë dhe faktit se i Akuzuari më pas ka marrë shumë mesazhe tipike që vijnë në rast kur gjindet jashtë rrejtis, Gjykata vlerëson

¹⁸faqe 49 e Mbështjellësit 2 # të shkresave të lëndës së Prokurorisë;

si të vërtetuar atë që është deklaruar nga Dëshmitari H. L., saktësisht se rreth orës 10:00 ai ka thirrur A. L., por ai ka hasur në marrje të dobët. Duke gjykuar nga koha, thirrja e dytë do të mund të jetë thirrja përmes së cilës i Akuzuari ka rrëfyer Dëshmitarit për vrasjen.

88. Ndërmjet thirrjeve me Dëshmitarin H. L., i Akuzuari ka marrë edhe dy thirrje tjera, një prej 26 sekondash në ora 10:21 dhe një prej 13 sekondash në ora 10:30 nga një numër pronari i së cilit nuk ka mundur të regjistrohet dhe identifikohet. Gjatë vlerësimit të besueshmërisë së të Akuzuarit lidhur me këto thirrje të pranuar, Gjykata nuk ka mundur as të përjashtojë dhe as të konfirmojë mundësinë se njëra nga thirrjet telefonike, në veçanti ajo prej 26 sekondash ka mundur të jetë thirrja përmes së cilës i Akuzuari ka marrë lajmin e vdekjes së motrës së tij.

89. Kjo pasiguri më tej argumenton faktin se Gjykata nuk ka mundur ta konstatojë të vërtetuar atë që i Akuzuari tanimë e kishte ditur për vdekjen e pretenduar të motrës së tij dhe, rrjedhimisht, kishte planifikuar vrasjen. Ky dyshim dhe prezenca e zgjidhjeve tjera alternative të mundshme dhe të besueshme duhej të interpretoheshin në favor të të Akuzuarit, në bazë të parimit *in dubio pro reo*.

90. Në bazë të këtij parimi, barra e vërtetimit e inkorporuar në detyrimin e Prokurorisë që ta vërtetojë fajësinë e të Pandehurit përtej dyshimit të arsyeshëm nënkupton se duhet vërtetuar se nuk ka alternativa tjera të arsyeshme përveç atyre të demonstruara nga Prokurori. Siç sqarohet nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në lëndën *Barberà, Messegué dhe Jabardo v Spanjë*, lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë. Neni 6 i Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNj),: “Para. 2 [i Neni 6] përfshin parimin e pandehjes së pafajësisë. Ai kërkon, mes tjerash, që gjatë kryerjes së detyrave të tyre, anëtarët e gjykatës nuk duhet të fillojnë me idenë e paramenduar se i Akuzuari ka kryer veprën për të cilën akuzohet; barra e vërtetimit i bie prokurorisë, dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të Akuzuarit.”¹⁹ Prandaj, ky parim ka të bëjë me të drejtën që të pandehet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia sipas ligjit. Më pas, në bazë të parimit *in dubio pro reo*, Gjykata, gjatë vlerësimit të fakteve dhe provave, duhet të jetë në favor të të Akuzuarit në rast të dyshimit.

91. Në mënyrë të ngjashme, në bazë të interpretimit të të njëjtit parim, fakti se në ditën kritike i Akuzuari me vete kishte një shumë relativisht të madhe parash nuk mund të vërtetohet si tregues i sigurt për ndonjë qëllim të arratisjes. Në të vërtetë, i Akuzuari para pak kohësh ishte kthyer nga bota e jashtme me qëllim që të martohej. Fakti që ai kishte për qëllim që paratë ti përdorte për të blerë dhuratë për gruan e tij të ardhshme do mund të paraqiste një shpjegim të besueshëm në realitetin e Kosovës, ku sistemi i bankave dhe kredit kartelave nuk është shumë i zakonshëm.

93. Një aspekt tjetër qenësorë lidhur me kualifikimin ligjor të kësaj vepre penale e që është ngritur para Trupit Gjykues ishte se i Akuzuari e ka kryer vrasjen në gjendje të afektit mendor dhe prandaj veprimi i tij i përket Neni 148 të KPK.

¹⁹ A 146 (1989); 11 EHRR 360 para 77 PC;

94. Një nga elementet që kërkohet nga Neni 148 i KPK është që i Akuzuari “ të privon nga jeta një person tjetër në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së fortë mendore të shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë **nga ana e personit të vrarë**”. Në rastin konkret, as nuk është pretenduar nga Mbrojtja e as nuk është mbështetur nga ndonjë provë e paraqitur se i ndjeri A. N. ka vepruar në atë mënyrë që ta shkaktonte gjendjen e tronditjes dhe të afektit mendor tek i Akuzuari. Prandaj, Trupi Gjykses konsideron të panevojshme që të elaborohet më tej nëse do të ishte e mundur që të vërtetohej me siguri që një thirrje telefonike e pranuar nga i Akuzuari do ta kishte shtyrë atë që ta kryej vrasjen, siç pretendohet nga Mbrojtja.

95. Në bazë të asaj që u cek më lart, Trupi Gjykses erdhi në përfundim se vepra penale nuk mund të kualifikohet si Vrasje në gjendje të afektit mendor, nga Neni 148 i KPK.

96. Prandaj, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i Akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje siç kualifikohet me Nenin 146 të KPK.

Lidhur me akuzën për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve

97. I Akuzuari e ka pranuar fajësinë për pikën e aktakuzës Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve. Ai ka pranuar se ka bartur armën për të cilën kurrë nuk ka pasur ndonjë leje, madje edhe në ditët para ditës kritike të datës 19 janar 2010 dhe megjithëse, siç u cek më lart, pistoleta nuk është gjetur kurrë, ai ka pranuar se e ka përdorur pistoletën TT të kalibrit 7.62 X 15 mm për ta vrarë të ndjerin Amir Nika.

98. Prandaj, Gjykata e konsideroi këtë fakt si të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

F. KUALIFIKIMI LIGJOR. Përgjegjësia penale dhe Dashja. Dënimi i shqiptuar.

99. Sipas Nenit 2 Para. (1) KPK: “Ndaj kryerësit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale”. I Akuzuari e ka kryer vrasjen e A. N. më 19 janar 2010 kur ka qenë në fuqi Kodi Penal i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 06 Prill 2004 me emrin Kodi i Përkohëshëm Penal i Kosovës. Ai është ndryshuar më 06 Nëntor 2008 kryesisht duke ndryshuar emrin në Kodi Penal i Kosovës. Nuk ka pasur ndryshime tjera legjislative që do të ishin më të favorshme për të Akuzuarin, sipas Nenit 2 Para. (2) i KPK.

100. Trupi Gjykses konstatoi se i Akuzuari ka kryer veprën penale të Vrasjes siç penalizohet nga Neni 146 i KPK. Të gjitha elementet e veprës penale në fjalë janë vërtetuar, siç u elaborua më lart.

101. Trupi Gjykses pastaj vlerësoi nëse janë vërtetuar elementet subjektive (të ashtuquajtura *mensrea*) të të Akuzuarit.

102. Sipas Nenit 11 Para. (1) KPK, personi konsiderohet penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Sipas dispozitës së njëjtë, personi është fajtor për kryerjen e një vepre penale në rast se ai e kryen veprën penale me dashje apo nga pakujdesia.

103. Prandaj janë tri elemente që duhet marrë në konsiderim: kryerja e veprës penale, aftësinë mendore të personit dhe qëllimin e kryerjes apo pakujdesinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

104. Së pari, është vërtetuar se i Akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje nga Neni 146 i KPK, siç është elaboruar në kapitullin D.

105. Së dyti, nuk ka dyshim për faktin se i Akuzuari ka qenë mendërisht plotësisht i aftë kur e ka kryer veprën. Raporti psikologjik²⁰ mbështet këtë konkluzion dhe asgjë nga shkresat e lëndës nuk sygjeron ndryshe dhe nga Mbrojtja nuk është ngritur ndonjë kërkesë e tillë.

106. Së treti, i Akuzuari, gjatë kryerjes së veprës, ka vepruar me qëllim. Neni 15 i KPK, kur përshkruan nocionin e qëllimit, thotë: “(1) Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. (2) Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.. (3) Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.”

107. I Akuzuari ka përdorur një pistoletë për ta vrarë viktimën. Ai ka shtënë pa rreshtur në drejtim të tij prej një distancë mjaft të shkurtë, që është indikative për qëllimin e tij që ta privojë nga jeta viktimën. Trupi Gjykues gjithashtu vuri në dukje sjelljen e të Akuzuarit menjëherë pas sulmit, kur i tregojë për vrasjen H. L. duke thënë “ Nuk keni nevojë të prisni. U krye tëra. Vajza është e vdekur dhe nuk ka arsye që ta kërkosh sepse e kanë gjetur trupin e saj dhe trupi i saj është në Mitrovicë. Ashtu si ma kanë thyer zemrën, ua kam thyer edhe unë atyre dhe ua kam vrarë djalin dhe tani E. N. 2. dhe A. janë bashkë në botën tjetër, E. N. 2. është gjetur e vdekur”²¹.

108. Andaj, Trupi Gjykues ka konstatuar se i Akuzuari është penalisht përgjegjës për Vrasje në shkelje të Nenit 146 të KPK. I Akuzuari ka kryer veprën me dashje direkte.

109. Në mënyrë të ngjajshme, Trupi Gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve nga 328 Para. (2) i KPK. Përkatesisht, i Akuzuari e ka vrarë viktimën duke përdorur, konkretisht pistoletën TT të kalibrit 7.62 X 25 mm, për të cilën nuk ka pasur Leje të Vlefshme për Armë.

110. Sikurse u cek më lart, sa i përket akuzës së dytë nuk ka dyshim sa i përket stabilitetit mendor të të Akuzuarit. Për më tepër, i Akuzuari ka kryer këtë vepër me dashje direkte. I

²⁰ Faqe 238 deri 253 e Mbështjellsit # 1 të shkresave të lëndës së Prokurorisë;

²¹ Shiko faqen 8 më lart;

Akuzuari e ka ditur qartë se posedimi dhe/ose pronësia e armës së zjarrit kërkon leje të vlefshme që të jetë e ligjshme. Ai ka zbuluar në deklaratën e tij se ai vetë nuk e kishte lajmëruar zhdukjen e motrës së tij sepse nuk kishte dashur të hyjë në stacioni e Policisë me armën që e mbante me vete.

111. Andaj, Trupi Gjykes konstatoi se i Akuzuari ishte penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve në shkelje të Nenit 328 Para. (2) i KPK. I Akuzuari e ka kryer veprën me dashje direkte.

112. Gjatë shqiptimit të dënimit penal, Gjykata duhet ta marrë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm, përkatësisht që të parandalojë aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke përmbajtur personat tjerë nga kryerja e veprimeve të ngjashme penale, edhe qëllimin specifik, që ta parandalojë kryerësin nga përsëritja e veprës penale. Sipas Nenit 34 të KPK: “Qëllimet e dënimit janë: 1) Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; dhe 2) Të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale”. Duke pasur këtë parasysh, Trupi Gjykes vendosi ta aplikojë dënimin e shqiptuar.

113. Sipas Nenit 64 të KPK: “Gjykata e cakton dënimin për veprë penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë veprë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit”.

114. Për veprën penale të Vrasjes, Neni 146 i KPK parasheh dënimin prej së pakut pesë vjet burgim.

115. Për veprën penale të Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, Neni 328 i KPK parasheh dënimin me gjobë deri në 7.500 Euro apo dënimin prej një deri në tetë vjet burgim.

116. Si rrethanë rënduese për akuzën e Vrasjes, Trupi Gjykes mori parasysh faktin se i Pandehuri ishte arratisur menjëherë pas kryerjes së veprës dhe është gjetur vetëm përmes një urdhëri për ekstradim. Gjithashtu, Gjykata morri në konsiderim se se vrasja e mikut dhe shokut si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrveshjeve dhe keqkuptimeve ndërfamiljare nuk mund të tolerohet dhe se ky është një rast i rëndë i veprimit kriminal, i cili duhet të dënohet në përputhje me këto rrethana dhe duhet të shërbejë si mesazh i përmbajtjes për tërë shoqërinë. Gjithashtu, duke e drejuar sulmin në mënyrë kaq të papritur dhe befasuese, nga një distancë kaq e shkurtë dhe duke përdorur armë kaq precize dhe efikase, i Pandehuri nuk i ka dhënë fare kohë viktimës që të sqarojë, të mbrohet apo të reagojë në çfardo mënyrë.

117. Si rrethanë rënduese për akuzën Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, Trupi Gjykes mori parasysh faktin se bartja e paautorizuar e armës është veprim kriminal i cili në shoqërinë siç është Kosova paraqet një rrezik të shtuar , për faktin se ekziston vazhdimisht ekziston rreziku i lartë që çdo lloj mosmarrveshje, qoft ndërmjet fqinjëve qoft mbrenda në familje, ka mundësi lehtë të eskalojë dhe veprimi i rrëmbimit dhe përdorimit të paligjshëm të armës mund të çojë në pasoja të rënda dhe të pakthyeshme. Trupi Gjykes konsideron se, sikur i Pandehuri të mos e kishte pasur në posedim, incidenti që mori jetën e re të A. N. nuk do të kishte ndodhur. Prandaj, dënimi i aplikuar është menduar si përmbajtje e fortë nga veprimet e tilla që, fatkeqësisht, janë akoma praktikë e shpeshtë në shoqërinë Kosovare.

118. Si rrethanë të përgjithëshme lehtësuese, Trupi Gjykes konsideroi faktin se i Akuzuari nuk ka të kaluar kriminale, se gjatë Shqyrtimit Gjyqësor ai e ka pranuar se e ka kryer vrasjen dhe se ka shprehur keqardhje, dhe faktin se e ka pranuar fajësinë sa i përket akuzës së posedimit të paligjshëm dhe përdorimit të armës.

119. Duke shqyrtuar dhe balancuar të gjitha rrethanave rënduese dhe lehtësuese, dhe, njëkohësisht, duke pasur parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit, Trupi Gjykes e konsideroi si dënim të drejtë shqiptimin e burgimit prej 10 vitesh për veprën penale Vrasje dhe 3 vjet burgim për veprën penale Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve.

120. Sipas rregullave të llogaritjes së dënimit përmbledhës nga Neni 71 i KPK, dënimi përmbledhës duhet të jetë më i lartë se secili dënim nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara. Prandaj, Trupi Gjykes shqipëtoi 12 vjet burgim si dënim përmbledhës.

121.Koha e kaluar në paraburgim nga data 05 mars 2010 është llogaritur sipas Nenit 73 Para. (1) i KPK.

G.SHPENZIMET E PROCEDURËS

120. Gjykata e ka shpallur të Akuzuarin **A. L.** fajtor dhe sipas Nenit 102 të KPPK, ai duhet të paguaj shpenzimet e procedurës penale. Duke pasur parasysh numrin e seancave që janë mbajtur dhe gjendjen ekonomike të të Akuzuarit, në pajtim me Nenin 102 Para. (4) të KPPK, Gjykata vendosi që i Akuzuari duhet ta paguaj shumën paushale prej pesëqind (500)€ si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale dhe lirohet nga obligimi për ti paguar shpenzimet tjera.

H. KËRKESA PASURORE

121. Trupi Gjykues vuri në dukje se Pala e Dëmtuar nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për kompenzim gjatë Gjykimit dhe është udhëzuar që, në pajtim me Nenin 112, Para. (2) i KPPK, mund të paraqesë kërkesa për kompenzim në kontest civil.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P. nr. 43/2010

Roxana Comsa
Kryetare e T. Gjykues

Hajnalka Veronika Karpati
Anëtare e T. Gjykues

Nuno Madureira
Anëtar i T. Gjykues

Chiara Tagliani
Procesmbajtëse

Këshillë Juridike:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të një kopje të aktgjykimit, sipas Nenit 398 Para. (1) i KPPK.